

**STATUT I SHOQËRISË
"ECOMETIPIACE" shpk**

Ne Tirane, sot me date 12/05/2021, unë **Malvin Gjeçi**, i lindur në Fier më date 05.07.1992, i identifikuar me Pashaporten te leshuar nga autoritetet shqiptare me nr.J20705037T e vlefshme deri me date 23.08.2022, i identifikuar me cilesine e "ortakut themelues "

Deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", ne ate Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise "**ECOMETIPIACE**"SH.P.K.

KREU I

Neni 1- Krijimi

Shoqëria "**ECOMETIPIACE**" shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Neni 2 - Personaliteti juridik

Shoqëria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "**ECOMETIPIACE**" SHPK është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Z.Malvin GJEÇI** , i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3- Selia

Shoqëria e ka selinë ne adresën Rr. 'Konferenca e Pezes', Godine private 1 kateshe, nr. 8, Tirane.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

Neni 4 - Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Organizim eventesh private dhe publike ;
- Manaxhim i artisteve dhe karrieres se tyre (kengetare, balerina etj) ;
- Sherbime te marrjes me qira pasurive te paluajtshme dhe luajtshme (te banesave, qe lidhen me sigurimin e ambienteve te akomodimit per artiste dhe te ftuar ne evente dhe te dritave);
- Projektim eventesh;
- Tregetim me shumice dhe pakice te pijeve alkoolike;
- Ofrim te sherbimeve muzikore, DJ Muzike live
- Shitje biletash per evenete;
- Sherbime argetimi te ndryshme;
- Operator Turistik;
- Agjenci Turistike.

Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij deri me 31.12.2050.

KREU II- KAPITALI

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10 (dhjetë) Euro. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem " i shoqerise **Malvin GJEÇI**, i datelindjes 05.07.1992, lindur ne Fier, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr.J20705037T, me date leshimi 24.08.2012.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) . Ortaku përgjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 8- Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;



STATUTI

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave të të tretet kufizohet me miratim të asamblese se ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

KREU II- ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 9- Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut të vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakut të vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Asambleja e ortakut të vetem vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rasti kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Asambleja e ortakut te vetëm mund të zhvillohet me pjesëmarrjen e ortakeve në vende të ndryshme, të lidhur me instrumenta e mjete të telekomunikimit, në përputhje me metodat normale të telekomunikimit, duke përfshirë këtu mënyrën elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit, që marrin pjesë në telekonferencë dhe/ose video-konferencë dhe/ose me mënyra të ngjashme elektronike, të mund të identifikohen dhe t'u jepet atyre mundësia të kryejnë e të marrin pjesë në diskutime, të marrin, dërgojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përdorur gjatë mbledhjes.

Neni 10- Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Malvin GJEÇI**, i datelindjes 05.07.1992, lindur ne Fier, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr.J20705037T, me date leshimi 24.08.2012.

Shoqëria mund të administrohet nga një Administrator i Vetëm ose nga dy a më shumë Administratorë, të cilët ushtrojnë të drejtat e dhëna atyre së bashku apo më vete.

Asambleja zgjedh sistemin e administrimit dhe në rast se ka më shumë administratorë, cakton numrin e tyre, që nuk duhet të kalojë pesën, si dhe të drejtat përkatëse.

Administratorët edhe mund të mos jenë ortakë dhe janë të rizgjedhshëm. Kohëzgjatja e tyre në detyrë është për një afat 5 (pese) vjeçar duke nisur nga dita e themelimit te kësaj shoqërie.

Kohëzgjatja e tyre në detyrë është për një kohë 5 (vjeçare), deri në revokim apo dorëheqje, ose për një periudhë të caktuar herë pas here nga asambleja.

Administratorëve u takon pagimi i shpenzimeve të kryera për arsye të punës së tyre. Asambleja e ortakut te vetem gjatë emërimit ose me vendim të vlefshëm deri në ndryshimin etij, mund të caktojë për ta një pagesë.

Neni 11- Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin

për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- g) raportoje përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratorët mund të emërojnë agjentë apo përfaqësues, për akte apo kategori aktesh të caktuara. Në çdo rast, kur përfaqësimi i shoqërisë i kalon një subjekti, që nuk është administratori, caktimi i të drejtës së përfaqësimit të shoqërisë rregullohet nga dispozitat e një prokure të përgjithshme apo të posaçme.

Neni 12- Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto



STATUTI

dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përfundim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13- Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni14 - Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 - Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar per gatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19 - Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe

e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20 - Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21 - Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përhithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përhithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përhithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22 - Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionerëve/ortakëve të shoqërisë që ndahen aksionerë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23- Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24- Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25 - Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 26 - Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe nenshkruset me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " ECOMETIPIACE " shpk

Malvin GJEÇI

MALVIN GJEÇI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ELONA A. SYLA**

**DATE 12/05/2021
NR REP 1679**



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 12.05.2021, para meje Notere ELONA A. SYLA, anëtare në Dhomen Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Administrative nr. 10 Tirane, rr. Shyqyri Berxolli, Pall. Aurora, Kt. II, Ap. 3, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: Malvin Gjeçi, atësia Kozma, amësia Florika, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë Libofshë; Nd. 320; H. 00; Ap. 000; Libofshë; Libofshë; 9310; Fier, lindur më 05/07/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027234582 dhe nr. personal J20705037T, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, Statut te shoqërisë " ECOMETIPIAC"shpk, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

